

NEXHAT AGOLLI

VËZHGIME RRETH VALLEVE TË KARAKTERIT LUFTARAK

Në krijimtarinë folklorike të popullit tonë, ndërmjet gjinive të tjera, vallet popullore zanë një vend me randësi të madhe shoqërore. Ato janë shprehje e gjallë e jetës dhe frut i krijimit artistik të popullit tonë. Studimi i kësaj gjinie paraqet interes të madh, veçanërisht kur asht fjala për tipe të veçanta kërcimi, të cilat i përkasin një shtrimje të madhe gjeografike.

Problemi në të cilin do të meremi këtu, ka të bëjë me tipin e valleve luftarake, kryesisht me: «Presën me tagana»¹, «Kërcimin me shpata» dhe «Këllicon e parë». Rreth këtyre valleve do të flasim në mënyrë pak a shumë të zgjanueme tue e shqyrtue landën si dhe aspektet e tjera që kanë të bëjnë me to; njëkohësisht tue ndjekë, qoftë dhe përmbledhtas, metodën krahasuese si për ngjashmërinë e tipeve ashtu dhe të aksesorëve të tjerë, që janë pjesë e pandame e këtyre lloj valleve e që luhen si në Ballkan ashtu dhe në Europë.

Të tri vallet, që i përmendëm ma nalt, mund t'i ndajmë: nga një anë, Presën me tagana², Kërcimin me shpata dhe, nga ana tjetër, Këllicon e parë. Këto, siç do të shohim edhe ma poshtë, ndryshojnë dhe dallohen në mes tyre për sa i takon përmbajtjes, strukturës, funksionit dhe mënyrës së ekzekutimit etj., elemente këto që kanë të bëjnë me përcaktimin e karakterit të këtyre lloj valleve.

Presën me tagana e kanë luejtë të gjithë fiset e Malsisë së Madhe, veçanërisht: Kastrati, Hoti edhe Gruda (këndej edhe përtej kufinit). Asht vështirë me folë për origjinën e kësaj valleje, po tue u nisë nga burimet gojore mund të thuhet se, asht ndër kërcimet ma të vjetër, ndoshta dhe ma i hershmi i kësaj krahine. Kjo valle simbolizon atë kohë të lavdishme të të parëve tanë për të cilët: forca, trimnia, burmia ishin në radhë të parë sa herë që e lypte nevoja, tipare këto të trashëgueme brez pas brezi nëpër shekuj.

Cilat qenë kushtet që e mbajtën gjallë këtë valle?

Këto kushte lidhen me ruajtjen e disa marrëdhanieve të vjetra që kanë të bëjnë me fisin. Nderimi ndaj të parit të fisit ishte shprehje e lidhjes të të gjithë pjestarëve nëpërmjet vijës atënore dhe, në radhë të pa-

1) Në Malsinë e Madhe kjo valle quhet: «Vallja e shpatave», «Kcimi me shpata», «Presa ose Premja me tagana» etj. Ne do të përdorim termën «Presa ma tagana» për ta dallue nga «Kërcimi me shpata» që luhet në katundet e Malsisë së Gjakovës. Kjo e fundit quhet — simbas informatorëve edhe «Kcim me shpatë në luftë kundra anmikut».

2) Presa me tagana dhe Këllicoja e parë janë filmue. Filmi ndodhet pranë AIF (Arkivi i Institutit të Folklorit).

rë, të territorit të përbashkët. Çdo fis kish një farë organizimi të vetin. Të gjitha çashtjet civile e luftarake zgjidheshin në kuvend të burrave. Një njeri që nuk ishte i gatshëm me ju përgjigj thirrjes për luftë e mbrojtje, që nuk tregohesh trim, që nuk e çonte në vend gjakun, ose që nuk e mban-te nderin, ai përbezej. Respekti për individin luftëtar rritesh, kur tek ai shifnin të mishnoheshin virtytet ma të mira të trashëgueme prej të parve për të rrujtë nderin dhe dinjitetin e fisit. Shpesh, nëpër mbledhje e kuvende, të parët e fisit pleqnoheshin për shumë çashtje tue ju drejtue me respekt të parve të tyne, trimnisë dhe urtësisë së tyne. Skena të tilla gjejmë edhe në shumë nga kangët e kreshnikëve, ku nëpërmjet përshkrimeve të gjalla e të bukura shofim të idealizohet figura e luftëtarit, apo të tregohen çil-tas virtytet e tij të nalta për tokën dhe nderin, sidomos në pasqyrimin e trimnisë së burrave, nga një anë, ose të heroit me personazhet negative, nga ana tjetër, në «bejleg». Po sjellim si shembull këto vargje nga kanga e Gjergj Elez Alisë:

M'ke lypë motrën para se mejdanin
M'ke lypë berret para se çobanin
E jam dredhe n'ket log për me t'kallxue
Se ne t'parët një kanu na kanë lanë
Armët me dhanë përpara e mandej gjanë!
Kur balozit motrën mos me ja dhanë
Për pa u pre n'at fushën e mejdanit.³

A nuk është edhe Presa me tagane jehonë e jetës dhe e këtyne kangëve? Pra, në këto kushte (ndoshta dhe ma herët), Presa me tagana erdhi dhe u ngrit deri në shkallën e një kërcimi simbolik tue hymnizue ato tipare burrnore dhe vlera morale të këtyne malsorëve, që tashma i njofim nëpërmjet krijimtarisë popullore, historisë ashtu dhe literaturës artistike etj.

Dihet se marrëdhانيت fisnore të së kaluemes në të cilat u kultivue kjo valle, me kohë filluen të diferencohen, në fillim sidomos në zonat fu-shore, si rezultat i zavendësimit të tyne me marrëdhانيت feudale e ma vonë të depërtimit edhe të formave kapitaliste në prodhim. Në Malsi mbe-turina të këtyne marrëdhanieve u ruajtën ma fort. Me vendosjen e push-tetit popullor marrëdhانيت e vjetra u zavendësuen me marrëdhانيت e reja socialiste në prodhim. Natyrisht, zavendësimi i një formacioni nuk presupozon zhdukjen përnjiherë të të gjitha formave dhe elementeve të së kaluemes, qofshin këto elemente edhe të superstrukturës. Ato ruhen dhe zhvillohen në kushte të reja. Pra, me prishjen e marrëdhanieve të vjetra Presa me tagana nuk u zhduk, ajo mbeti si një trashëgim i së kaluemes. Megjithëqë e ruen përmbajtjen, trajtën dhe qëllimin shprehës të saj, ajo gjatë gjysmës së parë të këtij shekulli e sidomos këto 15-20 vjetet e fundit u zhvesh nga disa elemente, të cilat duket se vijshin në kundërshtim me marrëdhانيت e reja. Asht fjala për zhveshjen e valles nga nocioni i vrasjes, «premjës së kokës» si shprehje (evidencim) ndoshta të hakmarrjes (ose të paktën se e ilustron atë) si një nga mbeturinat ma të këqia të së kaluemes.

Sot Presa me tagana sikundër dhe kanga e lahutarit përmbajnë një çast sublim në evokimin e së kaluemes. Në traditën vendase Presa me ta-

3) Instituti i Shkencave, *Këngë popullore legjendare*, zgjedhur e paisur me shë-nime nga Q. Haxhihasani, Tiranë, 1955, f. 125-126.

gan ka qenë vallja ma e preferueme e maleve. Ajo konsiderohet si çfaqja ma e naltë e serioze, mbasi nëpërmjet saj malsorit i pëlqente me e çfaqë burrninë, forcën, hijeshinë, e trupit, sepse vetëm në luftë ata gjejshin rast për të tregue shembullin e tyne. Pra kjo valle, edhe pse ban aluzion për një kohë të hershme, ngjall sot tek spektatorët forcë, krenari për heroizmin e së kaluemes, traditë kjo e trashëgueme deri në ditët tona. Kjo asht arësyeja që Presa me tagana asht trashëgue dhe mbajtë gjallë.


Përpara këtë valle e kanë luejtë zakonisht në log të burrave, kur mblidheshin për kuvend, ose për argetime (rrallë), asht luejtë gjithashtu edhe nder festa fetare në vende të caktueme, veçanërisht në oborrin e kishës (për shejtnit, krishtlindjet, të kremtet dhe në raste të tjera). Sot luhet në festa të ndryshme: lokale, krahinore, kombëtare si dhe në raste festivalesh folkloristike.

Tue e vështrime në përgjithësi këtë tip kërcimi (qoftë nga varianti i filmuem, qoftë nga të dhanat që kemi mbledhë gjatë kërcimeve tona në terren), mund të themi se ai paraqitet në përgjithësi i njëllajtë. Sigurisht vihen re disa ndryshime tepër të vogla në mënyrën e ekzekutimit, ose në qenien e ndonji elementi parazitare futun sigurisht në kohë të vona. Nji fabul e thjeshtë e karakterizon këtë valle: në plan të parë del ndeshja (lufta) e rreptë për jetë a vdekje me shpata ndërmjet dy burrave kundërshtarë. Për malsorin kundërshtari simbolizon armikun⁴. Dhe kjo shprehet aq realisht dhe bukur si nga ana kërcyese dhe e interpretimit sikur ata (valltarët) t'i jetojshin me të vërtetë ato çaste. Në këtë valle dyluftimi — thonë malsorët — ka fitue gjithmonë shqiptari.

Presën me tagana nuk e kërcen kushdo, po, natyrisht, ai që asht ma i zoti, ma i fuqishëm dhe ma i shkathët në përdorimin e shpatës. Në valle, siç asht zakoni kur bahet logu, dalin ata që ftohen nga i pari, kryetari i logut, i cili nga ana e tij i njëf kush janë valltarët ma në za. Ekzekutimi i valles në prani të spektatorëve që rrijnë rreth e përçark, përban momentin ma interesant të logut; e gjithë vemendja e tyne përqëndrohet tek ndeshja e dy luftarëve dhe sejcili syresh heshtazi reagon dhe çfaq simpatinë (spontanisht) për njanin ose tjetrin, dikush i nxit edhe me fjalë. Edhe valltarët nga ana e tyne mundohen me e tregue me sa kanë mundësi forcën dhe hijeshinë në kërcim.

Para se me e nisë kërcimin të dy kundërshtarët vështrohen rrebtas. Hyjnë njeni përkarshi tjetrit me hapa të zakonshme, të ngadalta, ndërsa me dorën e djathtë shtrëngojnë dorezën e shpatës; e nxjerrin prej millit, e mprefin nëpër te dhe e vërtisin nëpër ajër. E përplasnin njanën kambë për tokë, i turfullojnë njeni-tjetrit me inat dhe e nisin kërcimin tue u hudhë disa herë me të djathtën në vend, ndërsa e majta ngrihet përpara pak e thyeme (sa herë që hudhet dhe ulet prek tokën me majë) me kthimin e trupit nga e djathta dhe anasjelltas; këtë gja ban edhe valltari tjetër, pra kërcëjnë në pozicion të kundërt. Kjo lëvizje përsëritet disa herë. Mandej nisen në rreth ose përkundrejt njeni-tjetrit; hudhen me të majtën, ndërsa të djathtën e ngrejnjë pranë saj pak të thyeme, mandej bajnë nji hap me të djathtën. Kjo përsëritet edhe me kambë të kundërt dhe vazhdimisht derisa ndërrojnë vend, ose ndalen përkundrejt: filloj-

4) Në traditën vendase shpeshherë valltarët në mënyrë simbolike përfaqësojnë figura legjendare, ose dhe negative, mbrapa të cilëve fshihen edhe anmiq. P.sh.: njani nga valltarët përfaqëson Gjergj Elez Alinë kurse tjetri Arapin e zi, ose njeni Gjeto Basho Mujin dhe tjetri Galiqe Galanin.



në me i shfry njeni-tjetrit, i mprefin shpatat sërish, i përplasin në tokë për të tregue sa të fortë janë, e shtrëngojnë shpatën nëpër dhambë për të shprehë mllëfin, ose e tundin në ajër, ndërsa hudhen në vend (si në fillim) sa në njanin krah në tjetrin. Kjo e gjithë përsëritet dy tri herë. Gjatë kryqzimit mundohen me i ra me forcë njeni-tjetrit tue i ndeshë shpatat. Dy luftimi sa vjen e merr vrull, valltarët egërsohen, atëhere nis përleshja e shpatave pa pushim. Mënyra se si i përplasin ato me gjithë forcën e krahut: sa në një anë në tjetrën, në intervale kohe të ndryshme, herë tue i përplasë për tokë, herë tue marrë vrull e tue i ba reng, të jep përshtypjen se mjeti që përdoret duhet të jetë ma afër taganit se sa shpatës së zakonshme. Tue u rrotullue nëpër një qark të vogël: sa djathtas, majtas e tue i dhanë forcë me gjithë fuqinë e trupit, i përplasin shpatat aq fort sa qesin xixa. Dyluftimi mbrrin kulmin dhe sejcili mundohet ta godasë kundërshtarin ⁵.

*) Fotografitë janë të A.I.F.

5) Nji përshkrim të gjallë e tepër interesant mbi këtë valle, na jep F. Barkata në romanin «Lule» (1930), e cila, me sa kuptohej, asht luejtë në një vend afër Rubikut. Ndër të tjera shkruen: «Rregulluesi i lojnavë i ftonte burrat me dalë në shesh e me tregue trimninë e tyne. Mbas shumë të lutunash dhe mbasi u mundue gjatë, duel në shesh një burrë. Ky kishte në rrypin e vet të lëkurtë një tagan, atë armë të dashtun dhe përnjiherë aq të dashtun të kohëve të para. E nxuer prej millit, bani disa rrathë me hapa kërcimi, pastaj e hudhi me fuqi në tokë, kështu që ngeli e ngulun dhe filloi me iu sjellë rreth e përçark tue kacye. Pritte bashk-kacimtarin, anmikun e vet! Dhe ky i duel tue nxjerrë taganin përjashta tue bamë disa rrathë dhe tue hudhë armën në një mënyrë, që shkoi dhe u ngul me tehë pranë tjetrës. Ky asht sheji i pranimit të ftesës. Ju vërsulën që të dy taganavet, i zhgulën prej toke dhe filloi dyluftimi. Tëhat shkëlqejshin, shëndritshin, kryqzoheshin, tue i shkue për rreshqit trupit të kundërshtarëve. Lypej



Kërcimi, sikundër na ka ra rasti me e pa, përfundon në tri variante. Në variantin e parë ai që asht ma i fortë, në një moment të befasishëm, e kap kundërshtarin prej flokësh dhe e pret me shpatë.

Në variantin e dytë, në çastin kur luftëtarët bahen gati me u pre njeni me tjetrin, u hyn në mes një grue me djepin e fmisë (që simbolizon fëminë), për të ndalë premjen. Dyluftimi ndalet. Grueja u mer shpatat, ndërkaq dy luftarët, megjithse të inatosun, i shtrëngojnë dorën një-tjetrit bile edhe përqafohen⁶.

Në variantin e tretë, njërit prej luftëtarëve i bjen shpata në tokë, ndërkaq kundërshtari e ndalon atë për ta marrë tue e shkelë me kambë;

nji zotësi e madhe, një fuqi e veçantë, një shpejtsi e jashtëzakonshme, ashtu edhe një urti e posaçme, në mënyrë që loja të mos merte një përfundim të përgjakshëm.

Luftimit iu dha fund. Të dy luftarët i ngulën përsëri armët në tokë, u përqafoen u puthën, i nxuarrën taganat prej toke, i vendosën ndër rrypa dhe u larguen në mes duartrokitjeve dhe lavdimeve të popullit».

6) R. Wolfram shkruen kështu për këtë valle: Ma shpesh paraqitet i stilizuem një dyluftim me shpatë, karakteristikë sidomos në një formë shqiptare. Këtu asht fjala për një vajzë, e cila qëndron e qetë dhe pret përfundimin e luftimit. Kundërshtarët rrethojnë një-tjetrin tue përgjue dhe tue qëndrue në intervale të shkurtëna simbas karakteristikës shqiptare hapashalthi, sillen rreth vehtes së tyne, qëllojnë dhe mbrohen. Së fundi i thyemi largohet nga sheshi i luftimit, fituesi sjell shpatën tri herë mbi kryet e vajzës si shenjë që e ka ba të tijën dhe mandej vajza e ndjek. R. Wolfram, *Der Volkstanz A15 Kulturelle Ausdrucksform Der Südosteuropaischen Volker*, Munchen, 1962, p. 69. Nga kërkimet tona të deritanishme një përfundim të tillë të valles, siç e përshkruan Prof. R. Wolfram, nuk e kemi hasë, të paktën brenda kufijve të sotëm shtetnorë. Autori në veprën e cituar jep dhe një fotografi të kësaj valleje (foto 14). Aty shofim përveç lodraxhiut dhe një person tjetër që i bjen surles. Nuk dijmë se ku asht marrë kjo fotografi mbasi tek ne, me sa dijmë, vallja kërcëhet pa muzikë.



ky i fundit tue u gjetë në një situatë të tillë, i pa armatosun nuk tutet, por e çon kryet përpjetë gati me u pre prej shpatës së kundërshtarit. Fitimtari nuk e pret se i pëlqen ky xhest burrnje; e mer shpatën që ka nën kambën e tij, ia jep kundërshtarit dhe të dy përqafohen.

Ma afër së vërtetës dhe ma origjinal asht varianti i parë. Varianti i dytë dhe i tretë kanë hy vonë, sidomos ky i fundit në të cilin janë futë elemente të rij, bile me një paraqitje skenike (këtu asht fjala për ndikimin e drejtpërdrejtë të skenës profesionale në vallen popullore). Në këto variante ne shofim evolucionin që ka pësue vallja. Me fort përdoret varianti i dytë.

Kërcimi me shpatë, që luhet në malsinë e Gjakovës, përgjason së tepërmi me Presën me tagana të Malsisë së Madhe⁷; ata janë variante të njëni-tjetrit, jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë, në mënyrën e kërcimit, në strukturën ritmike të hapave, skemat, përdorimin e shpatës, reagimin e valltarëve, veshjen etj.⁸ Ndryshimi i vetëm asht se kjo valle shoqnohet me tupan (lodër)⁹; edhe ndamësi në këtë rast asht tupaxhiu dhe jo grueja si në malsi.

7) Praninë e fiseve të Malsisë së Madhe e gjejmë deri në Kosovë. Kështu p.sh. Rugovasit e mbajnë vehten për Kelmendas. Me gjithë largësinë ata i kanë rrujtë marrëdhëniet e tyre me krahinat e Malsisë deri në kohët e vona.

8) Kërcimi në fjalë luhet në shumë katunde përtej kufijve të sotëm shtetënorë si: Rugovë, Deçan, Llukë e Epërme, Voksh, Prelep etj. Luhet po ashtu në katundet e Pejës, si dhe në Drenicë.

9) Vonë, tregojnë informatorët, asht përdorë dajreja dhe sharkija (instrument kordeofon me gjashtë tela). Të dhanat për këtë valle i morëm nga D. Shaqia dhe D. Neziri, puntorë në koop. bujqësore Shinavlash rrethi i Durrësit.



Simbas informatorëve Kërcimi me shpata jo vetëm se shtjellon një moment ndeshjeje epike, por edhe asht luejtë gjithmonë në raste të shënueshme, veçanërisht kur niseshin për luftë. Në këto raste, në një vend të caktuem, mblihdeshin burrat nga një për çdo shtëpi me përjashtim të barijve. Aty bahesh nisja; disa këndoreshin kangë trimnie, dikush kërcente me tagana, ndërsa gjimonte lodra, kurse të tjerët ndaheshin me të afërmit. Ma vonë vallja asht luejtë edhe në raste të tjera.

Kërcimi nis në këtë mënyrë: para se me fillue me u ndeshë e nxjerrin shpatën prej millit dhe ecin me hap të zakonshëm në rreth, ndërsa shifen rrebtas njëni me tjetrin. Si bajnë një rreth ose dy ndalen dhe nisin tue u hudh lehtas në vend (tue u kthye majtas, djathtas), ndërsa kambën e djathtë e nxjerrin pak përpara në maje të gishtave¹⁰. Mandej ecin në vijë vertikale përkarshi njëni-tjetrit me këtë lëvizje; hap diagonal përpara majtas me të djathtën pak të thyeme (këtë e bajnë përkarshi njëni-tjetrit), ndërsa e majta ngrihet pak e thyeme mbrapa [kamba e majtë ulet në vend] hap me të djathtën anash me kthimin e trupit djathtas 90°; e njejtë lëvizje bahet edhe me kambë të kundërt diagonal përpara djathtas. E gjithë kjo përsëritet disa herë bile edhe me ritëm të shpejtë, tue u hudh (në hapin e parë), tue dublue hapat (hapin e tretë), ose tue shtue ndonji hudhje. Si e përsërisin edhe në rreth këtë lëvizje dy tri herë, ecin përsëri me hap të lirë, ose hudhen lehtë me hop dubël si tue rrëshqitë herë me të majtën, herë me të djathtën, ndërsa qëndrojnë përballë njëni-tjetrit. Përsëri marin vrull gjithë inat dhe nisen tue kërcye në rreth për ta kapë njëni-tjetrin, ndërsa shpatën e lëvizin nalt n'ajër. Ekzekutojnë këtë lëvizje: hudh-

10) Krahaso me Presën me tagana.

je më të majtën, ndërsa e djathta ngrihet pranë saj e thyeme [hap dubël në formë sinkope (me të majtën mandej me të djathtë)]; kjo përsëritet edhe me kambë të kundërt dhe kështu vazhdimisht deri sa e ndalin vrullin. Përsëri ekzekutohet lëvizja me hudhje të lehta në vend dhe në drejtim vertikal. Këtu fillon edhe përplasja e shpatave, ndërsa valltarët kryqzohen me njëri-tjetrin; hudhen përsëri në rreth tue kërcye, prap ndeshen, i përplasnin shpatat fort dhe, në çastin kur njëri nga ata bahet gati me e goditë kundërshtarin, ky i fundit ulet në gjunjë i mbrojtun nga shpata e tij, të cilën e mbërthen me të dy duart. Në këtë moment tupanxhiu me maçungën (shkopin e lodrës) e pengon kundërshtarin ta godasë. Kështu përfundon kërcimi. Valltarët çohen dhe përqafohen me njëri-tjetrin.

Lind pyetja, a konsiderohen Presa me tagana dhe Kërcimi me shpata si valle në kuptimin e vërtetë, ku siç dihet rregulli ritmik i lëvizjeve asht tipari kryesor? Tue u nisë nga çfarë thamë ma nalt se, në këto valle, funksioni kryesor asht ndeshja, atëhere mund të themi që nga ky tipar deri vonë edhe struktura e tyre. Në këtë mes duket ka ndikue edhe ekzekutimi heshtazi, pa muzikë, siç asht rasti i valles Presa me tagana. Shpesh herë lëvizjet hudhëse në vend, ecjet me hudhje, përplasjet e shpatave etj., ngjasin e ndrrojnë në vartësi nga njëri ose tjetri valltar në momentin e dhanë. Kjo vërehet në tanësi në trajtën e këtyne valleve. Edhe pse shtjellojnë një ide dhe kanë vazhdimësi nuk mund të themi se e kanë inkuadrimin e një valleje në kuptimin e vërtetë të fjalës. Tue i pa nga kjo anë, me strukturën e tyre të pakristalizueme këto kërcime, duket se qëndrojnë në mes të dyluftimit nga një anë dhe valles nga ana tjetër. Megjithatë, tek Kërcimi me shpata (Gjakovë) kemi përshtypjen se lëvizjet paraqiten me një ritëm ma të përcaktuem, mbasi vallja shoqnohet me tupan, instrument membranofonik tepër ritmik.

Për sa i takon trajtës dhe mënyrës së shprehjes së mendimit një lloj tjetër i veçantë na paraqitet Këllicoja e parë. Kjo valle luhet në rrethin e Kukësit, sidomos nga pleqt e katundit Shtiqën¹¹. Për një valle të tillë, të afërt ndoshta me këtë, flasin motrat Jankoviq në vëllimin «Valle popullore» ku ndër të tjera thuhet: «Në këtë kohë (asht fjala për një kohë të hershme — sh. N.A.) mundet që Kalaçi me shamat e kryqzue me ka qenë ma afër lojës nga e cila asht zhvillue, që simbas disa shenjave, të cilat mund të supozohen, ka qenë një lojë burrash me shpata të kryqzue, që ma vonë i kanë zavendësue shamat dhe lëvizjet e kreshnikëve janë zbutë nën ndikimin e stilit të Prizrenit. Myslimanët edhe sot e luejnë Kalaçojnë me shpata (tagana), por të shoqnueme dhe me melodi të tjera. Prizrenjanët mendojnë se kjo, Kalaçoja, nuk ka kurrëgjatë të përbashkët me Kalaçin, të cilën e luejnë të krishtenët». Nga thania e masipërme, sikundër vërtetohet edhe nga të tjerë, kuptohet se, në këtë rast, kemi të bajmë me degëzimin e këtij lloji kërcimi në një trevë pak a shumë të caktueme. «Në Kosovë e Metohi si dhe në Makedoni — shkruen L. Antoni — megjithse rrallë, luhet edhe sot lojnat, ose vallet e vjetra darsmore të quejtuna Kallagjoja ose Këllicoja. Gati sejcila trevë ka kallagjojnë e vet, por këto dallohen prej njena-tjetrës si përkah mënyra e të vallzueimit ashtu edhe përkah përcjellja muzikore...» Ma poshtë shton edhe këto: «Megjithse

11) Valltari i talentuem I. Shehu tregon se këtë valle e ka pa dhe mësue nga njëri ndër të tjerë, të moçëm, të cilët kanë jetue nga shekulli i kaluem e deri në fillim të këtij shekulli. Kjo valle asht luejt edhe në katundet: Vërnice, Zhur, Shkozë, Bolliqe etj., të cilat përpara shkojshin si bajrak me Bicajt e Kukësit, kurse sot janë me rrethin e Prizrenit.

përkah karakteri i tyre janë trimnore, sot këto ma nuk luhen me shpata dhe nëpër qytete i ekzekutojnë edhe femnat. Këto lojna luhen veçanërisht nëpër darsma. Kallagjojnë të shumtën luhen në Metohi, sidomos në Prizren.¹²

Ajo që i afron këto valle asht edhe titulli. Pleqt e Shtiqnit e quejnë «Këllicoja e parë», ndërsa simbas L. Antonit, në Metohi, shqiptarët myslimanë i quejnë këto lloje vallesh «Këlëçojni», shqiptarët katolikë «Kaladojni». Pavarësisht nga titulli, ne e kemi të vështirë të bajmë krahasim si në drejtim të strukturës, ashtu dhe të stilit, sepse shembujt që përmen-den nuk na japin mundësi të tillë. Përsa i takon zavendësimit të mjetit që përdoret, shpatës, me objekte të tjera si: shamia apo shkopi etj., ky tashma asht një fenomen i njoftun që, sikurse thotë Delzanglez, filloi që në mesjetë. Edhe fakti që kallagjojnë luhen me melodi të tjera nuk duhet të na çudisë sepse raste të tilla ndodhin. Në rrethin e Kukësit luhet edhe një valle tjetër e quejtun Këllicoja e dytë, në të cilën nuk përdoren shpatat. Ndoshta mbiemni «e parë» «e dytë» shërben për të dallue një-nën melodi të valles nga tjetra. Fenomene të tilla ndodhin dhe, në cilatdo forma që ato çfaqen, nuk duhet të na e largojnë vëmendjen nga qëllimi për të gjetë atë që asht jo e përbashkët në një kategori vallesh.

Këllicoja e parë, edhe pse nuk paraqet ndeshje të drejtpërdrejta, të çudit për interpretimin, për mënyrën serioze, randë-randë dhe burrnore të ekzekutimit. Shpata ka funksion vetëm demonstrativ. Thuhet se në këtë kërcim bahet paraqitja e armëve. Simbas informatorëve, në kohë të para kjo valle luhej gjithmonë përpara luftimit.

Ndërsa fillon melodia e valles, ekzekutue nga surlja dhe lodra, valltarët ecin në rrethin e valles me hap të lirë, ndërkaq nxjerrin nga milli shpatën. Në një moment të caktuem valltarët e nisin kërcimin. Një frymë epike e përshkon këtë valle, ndonse kjo ekzekutohet me një ritëm të ngadaltë; çdo lëvizje, xhest, apo veprim buron nga mbrenda, sepse çdo valltar jeton kah e kërcen vallen. Karakteristika për këtë valle asht lëvizja asimetrike, e cila përmban në vetvehte elemente të zhvillueme nga pikpamja plastike¹³.

Vallja karakterizohet prej një motivi, i cili përsëritet vazhdimisht gjatë valles, ngandonjiherë edhe i zhvilluem, rast ky që kondicionohet nga ndryshimi i drejtimit të zhvendosjes së hapave. Karakteristikë e këtij motivi janë këto hapa: hap kali i vogël me të djathtën pak i thyem (edhe e majta thyhet pak në vend) me kthimin e trupit gjysëm djathtas. Dora e majtë del përpara pak e thyeme, ndërsa e djathta me shpatën shkon anash/i njejtë hap me të majtën. Dora e djathtë del përpara me shpatën, ndërsa e majta shkon diagonal mbrapa; përsëritet hapi i parë, kamba e majtë afrohet në majë të gishtave pranë së djathtës (e djathta çohet në vend) me kthimin e trupit gjysëm majtas. Dora e djathtë del përpara me shpatën, ndërsa e majta vendoset në bel / thyemja e lehtë me të dyja kambët në vend në të njejtën kohë shpata lëvizë pak përpara / hap kali pak i thyem me të majtën anash nga e majta (e djathta thyhet pak në vend). Dora e majtë del anash / kamba e djathtë afrohet në maje të gishtave pra-

12) L. Antoni, *Kaladojnat*, Buletini i Muzeumit të Kosovë-Metohisë, Bleni III, Priştina, 1958, f. 248 (përmbledhje).

13) Nga të dhanat që kemi, konstatojmë se një nga tiparet kryesore të strukturës së valleve të grave në vendin tonë asht lëvizja asimetrike. Këtë tipar e vemë re dhe në shumë valle të tjera që luhen nga burrat.



në së majtës, ndërsa trupi kthehet pakës djathtas. Dora e majtë del përpara pak e thyeme, ndërsa e djathta ulet diagonal mbrapa/. Trupi kthehet përpara drejt qendrës; dora e djathtë me shpatën del përpara, e majta vendoset në bel, ndërsa të dyja kambët thyhen lehtas në vend tue e lëvizë njëkohësisht edhe shpatën si në rastin e parë.

Këto janë hapat për bamës të këtij motivi, të cilët i përshkruem vetëm nga ana plastike. Përsëritet dy herë gjithnji në drejtim të rrethit nga e djathta. Herën e tretë (rastis edhe herën e dytë) valltarët hyjnë në qendër të rrethit edhe, në momentin kur rrotullohen për t'u largue përsëri nga qendra, i takojnë shpatat lehtë. Në këtë rast hapi fillestar i motivit (hap kali) nuk përsëritet tri, por gjashtë herë; mbas saj vijnë hapat që u përshkruen ma sipër. Në këtë mënyrë vallja ekzekutohet deri në fund. Rol në ekzekutimin e valles luen surlja e veçanërisht lodra, e cila me të ramet e forta ndikon jo vetëm në gjendjen shpirtnore të valltarëve, por edhe në

theksimin e lëvizjeve në momente të caktueme. Ky theks asht një impuls i brendshëm. Vështrimi i syve asht i thellë dhe plot kuptim. Gjatë ekzekutimit valltarët trupin e mbajnë pak si të tendosun, sidomos pjesën e sipërme, e cila sikur anon pak përpara në momentin kur ekzekutohen hapat anash.

Numri i valltarëve pjesëmarrës përmban një aspekt tjetër që ndikon në trajtën e valles. Në të tri vallet, për të cilat u fol ma nalt, numri dhe funksioni i valltarëve paraqitet në një farë shkalle i ndryshëm.

Këlliçoja e parë luhet me katër burra (rrallë qëllon me ma shumë). Vallja ekzekutohet në një formë të përcaktueme pavarësisht nga virtuziteti që ka ky ose ai valltar në interpretimin e saj. Dy kërcimet e tjera luhet me nga dy valltarë dhe prej një personi të tretë i cili kryen rolin e ndamësit; pra funksioni i këtij të fundit asht i njejtë në të dy vallet, ndonse i shprehun në mënyrë të ndryshme. Tek Kërcimi me shpata rolin e ndamësit e luan lodraxhiu, i cili në çastin e pritun hyn në mes të dy luftarëve dhe me shkopin (maçungën) e lodrës e pengon ma të fortin (fitimtarin) ta godasë kundërshtarin; ky i fundit ulet në gjunjë tue u mbrojt me shpatën e tij, të cilën e mbërthen me të dyja duert. Përkundrazi tek Presa me tagana si person i tretë mer pjesë grueja. Funksioni i saj konsiston në faktin që ajo bahet shkak për ndalimin e dyluftimit pikërisht në çastin kur ata (luftarët) bahen gati me u pre me shpatë. Ajo u hyn në mes: dyluftimi ndërpritet, valltarët në fillim shifen keqas, por mandej i shtrengojnë dorën njëni-tjetrit dhe përqafohen. Nga të dhanat që kemi, nuk rezulton që grueja me praninë e saj të anojë kah njëni ose tjetri valltar, ajo asht e paanshme dhe qëllimi i saj asht për me e ndalë gjakun¹⁴. Ka gjasë që ndërmjetsimi i grues në valle të jetë një fenomen i vonë. Këtë e justifikon fakti që, mbasi grueja i ndan për tu miqsue, kërcejnë të tre sëbashku ose hyn edhe një grue tjetër¹⁵. Kjo shtojcë asht e vonë dhe ka nisë të praktikohet qysh se asht lanë premja (vrasja e kundërshtarit). Simbas variantit të parë, siç e përmendëm ma nalt, fitimtari si e mposht kundërshtarin, sillet vetë lirshëm tue e lëvizë shpatën në ajër e tue u krenue.

Në vallet luftarake, apo të shpatave në përgjithësi, mjeti që përdoret (shpata) nuk ka të njejtin funksion. Ndersa në disa prej tyne shpata përdoret si pjesë e rituelit, në ato me karakter luftarak në ma të shumtën e rasteve shpreh efektin e ndeshjes tue u përdorë si mjet luftimi. Ekzistenca tek ne e valleve të tilla ku shpata ka funksion goditës, asht një veçori që lidhet me traditën vendase. Për të parët tanë, ilirët, shpata qe mjeti ma i afërt mbasi me të ata mbroheshin¹⁶.

14) Natyrisht personi i grues lidhet ngushtë me kushtet e veçanta të marrëdhënieve fisnore dhe të së drejtës konunore në të cilën ka jetue grueja malsore. Shpesh herë në traditën vendase ne gjejmë një çfaqje të tillë që në luftë me anmiqtë, ose ndërmjet fiseve, grueja hynte më djepin e femijës mbi krye (fëmija simbolizonte shejtin) për me i nda dhe shpesh ja mbrinte qëllimit. Grueja sikundër thuhet në kanun «s'bien në gjak». Vonë, aty nga çereku i këtij shekulli dhe sidomos mbas çlirimit të Atdheut, tregon informatori T. Marashi, figura e gruas u fut edhe në valle si rikujtim i traditës. Për rolin e gruas shif: Injac Zamputi, *Pozita shoqërore e grues malsore shqiptare sipas kanunit*. Buletin i U.S.H.T. Seria shk. shoq. 1961, Nr. 2, f. 101-123.

15) Ky kërcim asht një variant i Kërcimit të logut.

16) Dr. L. M. Tallozy, tue folë për ilirët, shkruen: Armët e tyne ishin një shijetë e shkurtën hudhëse, një shpatë në formë thike, një shtizë, ata e njifshin edhe shpatën e përkulun kelte dhe përdorshin hoben. Dr. Ludwig Won Tallóczy. *Yllyrisch Albanische Forschungen*, I. Band 1916... S, 21.

Tek Presa me tagana dhe Kërcimi me shpata, shpata përdoret si mjet goditës ndërmjet luftarëve dhe asht pikërisht kjo veçanti që u jep atyne një karakter të theksuem luftarak. Bile, tek vallja e parë vërehen edhe nuanca të tjera në përdorimin e shpatës: parase me u ndeshë, e prefin atë mbi çitjanet, me këllëfin; e përplasnin në tokë gjatë kërcimit për me tregue sa e fortë asht, ose e hudhin shpatën dhe ajo ngulet në tokë (simbas variantit përshkrue nga F. Barkata që cituem ma nalt). Tek Këllicoja e parë sejcili valltar shpatën e mban në dorën e djathtë dhe nuk e përdor si mjet goditës. Shpata asht si një aksesori, megjithatë i randësishëm i vallzimit, dhe vetëm në çastin kur valltarët hyjnë në qendër të rrethit e rrotullohen për të dalë, i përplasnin ato lehtë.

Një aspekt tjetër me randësi në ekzekutimin dhe interpretimin e këtyne valleve paraqet shoqërimi muzikor. Këllicoja e parë përcillet me surle e lodër, ka një vijë melodike dhe një skemë ritmike të përcaktueme. Kërcimi me shpata kohë përpara asht luejtë me tupan (lodër), kurse ma vonë, aty nga fillimi i këtij shekulli, nisi të shoqnohej me def bile edhe me sharki (instrument kordeofon me gjashtë tela). Ban përjashtim Presa me tagana e cila luhet pa muzikë. Ekzekutimi i kësaj valleje heshtazi, me sa duket, asht një fenomen i rrallë. Një fenomen i tillë e ka shkakun dhe asht i kuptueshëm po të meret parasysh kërcimi (përmbajtja, karakteri i tij) i lindun dhe i praktikuem në kushte të veçanta jetësore. Kur folëm ma nalt, këtë valle e konsideruem si një kërcim që qëndron në mes të valles dhe dyluftimit, sepse të dy këto elemente gërshetohen tue ia nënshtrun një farë ritmi (nga të dy valltarët dhe kjo varet nga aftësia e tyre), nëse e marrin këtë në kuptimin e gjanë të fjalës. Mungesa e shoqimit muzikor duhet kërkue në vetë mbrendinë e kërcimit dhe si rrjedhim në mjetet shprehëse të tij, të cilat përcaktojnë strukturën plastiko-ritmike të valles. «... ritmi i kangës, thotë Plehanovi, përcaktohet gjithnjë në mënyrë rigoroz nga ritmi i procesit të prodhimit»¹⁷.

Përkundrazi A. Bartalan e shef pak në mënyrë kontradiktore çeshtjen e shoqimit të valleve në mënyrë të heshtun. «Mbas mendimit tim të dy vallet shqiptare (asht fjala për Presën me tagana dhe Kërcimin e logut — sh. N.A.) që hudhen heshtazi pa muzikë, asht diçka e derivueme dhe nuk mund të shpjegohet me gja tjetër, veçse me atë kulturë deridiku të varfnueme të fiseve që jetojnë në Veri të Shqipnisë, kulturë me tipare të veçanta e të formueme përmes shekujve të historisë»¹⁸. Autori duket sikur bie në një farë kontradikte, kur në një paragraf tjetër ma nalt thotë: «Hudhja e valles pa shoqim muzike asht një karakteristikë e tillë që, me sa dijmë deri sot asht një diçka e pashembullt në Europë me përjashtim të rastit të valleve që hudhen në formë dueli e që ekzekutohen pa muzikë; pra asht diçka karakteristike që vallet i hudhin pa shoqim muzike, kange ose pa ndonji shoqnes tjetër që jep ritmin»¹⁹. Pra, ekzekutimin e valleve të tjera pa shoqim muzikor, përveç valleve në formë dueli, ai i konsideron si diçka të pashembullt. Atëhere këtu duhet marrë në konsideratë edhe «Kërcimi i Logut». Mos vallë autori shef edhe në këtë kërcim erotik një formë të çfaqjes së duelit. Në qoftëse kjo asht e drejtë,

17) G.V. Plehanov, *Estetika dhe letërsia*, (përkthim shqip) vëll. I, Tiranë, 1961, f. 68.

18) A. Bartalan, *Parbajyszerű tançainteról* (Danse «duels» en Hongrie). «Etnographia» LXXIV, Budapest, 1963.

19) Idem.

atëhere edhe në këtë rast duhet të kemi parasysh permbajtjen e valles²⁰. Përsa i përket kësaj veçorie, pra shoqimit pa muzikë të këtyre dy valleve tek ne, kjo asht një traditë e trashëgueme, burimin e së cilës duhet ta kërkojnë në vetë përmbajtjen e valleve kondicionue nga jeta.²¹

R. Sokoli shpreh këtë mendim lidhun me këtë tip vallesh: «Nji tip motivesh edhe ma interesante janë vallet e heshtuna të Malsisë së Veriut, të cilat kërcehen pa muzikë, simbas ritmikës që u vlon në gji valltarëve, porsì nji kangë e heshtun e organizimit të tyne. Në këtë tip vallesh paraqitet bukuria e nji kërcimi të lirë e ekspresiv me nji ritmikë plastike të heshtun, pra pa muzikë, sepse euritmia e tyne buron prej vetë trupit të valltarëve, të cilët shprehin plastikisht jetën e tyne të mbrendshme pa ndihmën e muzikës.²²

Në Malsi dhe në Veriun e Shqipnisë përdoren instrumenta të tillë si: lahuta, fyelli, çiftelia, surlja, lodra etj. Këto vegla dhe të tjera përdoren edhe përtej kufijve të sotëm shtetnorë. Nuk do të na çudiste fakti në se në Malsi të përdreshin: lodra, surlja e ndonji instrument tjetër vallesh. Nëse nji kategori vallesh shoqnohen me kangë, surle, lodër, me çifteli, ose pa muzikë, kjo parasëgjithash duhet pa në qëllimin dhe karakterin shprehës të valles e cila për shekuj me radhë asht ushqye nga tradita dhe e ka pasqyruë atë. Nji analogji të tillë shofim edhe tek kangët e kreshnikëve, të cilat përcillen vetëm me lahutë e jo me ndonji instrument tjetër sikurse ndodh sot në disa krahina ku kanë hy instrumenta të tillë si fizarmonika në shoqimin e kangës, në grupet e sazeva, si shoqnes në funksion të isos (rast i rrallë por flagrant) etj. Pra, përdorimi i llojit të instrumentave duhet marrë në raport me vallen. Asht tjetër gja nëse kjo çashtje meret si nji problem muzikor më vehte.

Malet tona ruejnë në gjinin e tyne edhe sa e sa valle të tjera burrash. Këto kaluen përmes shekujve si dëshmi e gjallë e krijimit artistik të popullit. Në ma të shumtën këto valle shprehin nji karakter të theksuem burrnor dhe nji frymë epike. Në lëvizjet e këtyne valleve duket se asht përgjithësue jeta e shqiptarit të motshëm: i fortë, trim dhe që kërkon të jetojë i lirë! Kjo asht e vërtetë. Këto valle karakterizohen nga nji frymë e tillë edhe sot e kësaj dite. Pavarësisht se nuk përdorin mjete (shpata, shkopij etj.), se në vallen e sipërme nuk ka lëvizje dhe figura ndërluftuese, prapseprapë ato ruejnë në vetvehte tipare luftarake, gja që kuptohet edhe nga fakti se shumë prej kangëve që i shoqnojnë këto valle, janë kangë trimash. Për këso vallesh na flasin ndonse kalimthi, edhe të huej të cilët janë marrë me probleme historike, gjuhësore e folklorike në vendin tonë kohë përpara. Këto dëshmi, ndonse të pakta, janë jehonë e së

20) Po sidomos kënga e dashurisë është ajo që shpalon shpirtin e fshehtë të këtyre njerëzve dhe institucionet e tyre. Karl Dietrich thekson se nga shkaku i mbylljes së gjinisë femërore duhet që në jetën dashurore të këtyre popujve fshehtësia të lozë një rol shumë më të madh se gjetkë. Citue nga E. Çabej, *Për origjinën e literaturës shqipe*, «Hylli i Dritës» Serje e Re, I, Shkoder 1939, f. 50.

21) A. Bartalan, përmend raste të valleve që shoqnohen me goditje ose pa shoqnim muzike. Hungarezët e asaj kohe (të kohës së Tinodit — sh.N.A.), që dojshin me vallzue, merrshin nji tenxhere të vjetër dhe tue goditë mbi të i jepnin ritmin valles. Ja, këtu tradicionalisht vallen e hudhin pa ndonji shoqnim muzikor. Autori përmend edhe vallen «Trestem» (Austri) pjesa e parë e së cilës luhet pa ndonji shoqnim. Në Pinzgau këtë valle e hudhin në datat 5, 6 janar të çdo viti dhe e konsiderojnë si nji valle kultike, që simbas besimit të vendasve hudhet për të ndjellë në vitin e ri mirëqenie shëndetsore dhe bollëk material; kjo valle hudhet nga valltarë të veshun me maska Përchtet. Idem.

22) R. Sokoli, *Vallet shqiptare*, Rev. Nendori, 1954, Nr. 8.

kaluemes, pararendëse të valleve që luhen sot në të katër anët e vendit tonë. Ja disa prej tyne:

«Ashtu si tek një popull luftarak, tek ato këndoheshin kangë lufte shoqnie me bilbil dhe gajde, ndërsa brini i pijes kalonte nga dora në dorë dhe vallzohesh një valle armësh e egër. Iliri kërcente rrotull me shpatë të zhveshun²³ ashtu si dhe shqiptari i sotëm gjatë valles qëllon me pushkën e tij të gjatë, ose tund hanxharin e tij».²⁴

Një tjetër autor, A. Smilari, në veprën e tij «Gli Albanesi d'Italia» ndër të tjera shkruen: «Shqiptarët dhe veçanërisht arnautët e Maqedonisë kanë rrujtë një tjetër valle që e quejnë arnautë, me anën e së cilës përfaqësojnë, megjithë në mënyrë të rëndomtë, marshimin dhe lëvizjet e fallangave të Aleksandrit. Të mbledhun në numër të dyqint vetëve radhiten njëni pranë tjetrit tue u shtrëngue për brezi në mënyrë që të formojnë një trup të vetëm. Janë korifejt që ju prijnë me një thikë në dorë. Në lëvizjet e tyre qarkullore, herë duken sikur formojnë një këshill lufte (kuvend lufte), herë një parakalim, herë rrjedhën e një lumi, herë sulmin e Dariut të përfaqësues prej një tjetër grupi që vjen në drejtim të tyre».²⁵

«Zonja Chenier, nana e poetit të madh Frances, na jep një përshkrim interesant të një pantomime ekzekutue nga korporata e kasapëve maqedonas të Konstandinopolit mbrenda hippodromit. Kjo pantomimë, në të cilën merrshin pjesë dy ose treqind persona, shumica të armatosun, mbante emnin vallja shqiptare»²⁶. Ma poshtë shton edhe këto: «Shkencëtarja greke e shikon këtë valle luftarake, të korporatës maqedonase, si shprehje lidhun me trimnitë e Aleksandrit të Math»²⁷. Duket sikur, A. Smilari dhe zonja Chenier, bajnë fjalë për të njejtën valle, megjithë që i pari e quen arnautë kurse tjetra shqiptare.

Një përshkrim me interes ka lanë T.S. Hughes, i cili vizitoi Shqipëri në fillim të shek. XIX. «U kënaqën ma tepër me çfaqjen e fundit, që ishte Alvanitiko, ose vallja kombëtare e palikarëve shqiptarë. Kjo u ekzekutue nga ushtarët e vezirit, që ishin të ftuem në festë. Zhvillimet dhe figurat e këtij ushtrimi vinin në dukje shkathtësinë e këtyne malsorve të fortë, të cilët tue u mbajtë dora-dorës, lëvizin në fillim ngadalë, herë përpara, herë mbrapa, mandej silleshin tue përzi edhe zanet e veta me tingujt ekzistues të muzikës. Në të njejtën kohë korifeu (ose udhëheqësi), i cili ndërroresh vazhdimisht, bante disa kërcime të paprituna, përkulesh nga mbrapa deri sa koka t'i mbërrinte gati në tokë e mandej hudhej përsëri lart me shkathtësinë elastike të një harku, ndërsa flokët e gjata i derdheshin të ngatërruem në një mënyrë të egër përmbi shpatull».²⁸

De Rada tek «Fiamuri i Arbërit» na jep përshkrimin e një valleje të vjetër burrash: «Në vitin 1829 erdhi nga Shqipëria në kolonitë tona një burrë që kishte qenë në ushtrinë e Ali Pashë Tepelenës dhe hodhi në shtëpinë tonë valle trimnie që nuk ishte tjetër veç një kërcim. Kjo valle kërcesh ma parë prej burrave tanë të lashtë dhe na kujton edhe sot vallet

23) Athenus, I. Cap. VIII — citue nga Dr. Ludwig won Tallozy, Idem.

24) Thania tjetër (shen. N.A.)... ashtu si dhe shqiptari i sotëm etj. duket se i takon Tallozy-it, Idem.

25) A. Smilari, *Gli Albanesi d'Italia, loro costumi e poesie popolari*. Napoli, 1881, p. 19.

26) G. N. Sathas, *Documents Inédites Relatives à l'histoire de la Grèce au Moyen-âge*. Publiés sous les auspices de la Chambre des Députés de Grèce, Tom., IV, LXXVIII.

27) Idem.

28) T.S. Hughes, *Travels in Greece and Albania*, Ed. London, 1830, vol. II, p. 108.

që hudhën në fshatrat tanë». Ma poshtë shton edhe këto: «Kjo valle arbërishte asht quejtun valle burrnje dhe tue marrë emnin e Pirros, asht quejtun valle Pirrike, d.m.th. e Pirros, birit të Akilit. Kjo valle që u hudh në Romë dhe mbeti prej shokëve të Enesë që e kanë luejtun të parët e Italisë, sikurse e ka quejtun Palermoni «Valle e Salenjëve», asht e njejtë me vallen Pirrike. Le të hidhemi ma larg tek historia e kësaj valleje që e ka burimin nga fiset e hershme të Trakës, para se të vijshin helenët dhe sllavët. Kjo s'asht tjetër veçse valle e vjetër arbërishte dhe e shokëve të fiseve të tjera që ndoshta të jenë të një gjaku me shqiptarët në kohën e Omerit e të luftës së Trojës». ²⁹

Si dëshmi me vlerë duhen pa edhe dy tabllotë e piktorit kroat P. Jovanoviçit punue nga fundi i shek. të kaluem. «Vallja e shpatave» dhe «Mësimi i shpatës» ³⁰. Në të parën tregohet, në një ambient të gjallë dhe ekspresiv, një valltar shqiptar (nga Malsia e Madhe) i veshun me fustanellë tue kërcye me dy shpata ngritun në ajër, ndërsa për rreth të pranishmit përplasnin duert. Në të dytën paraqitet një moment nga mësimi i shpatës, që një malsor shqiptar i jep një malazezi të vogël. Tablloja «Vallja e shpatave», si dokumentacion në pikturë, shërben si një dëshmi tjetër e gjallë e ekzistencës dhe e praktikimit të kësaj valleje ndër malsorët e Malsisë së Madhe.



* * *

Çashtjet e trajtueme në këtë punim, lidhun me vallet e karakterit luftarak që luhen në Shqipni, padyshim, paraqesin interes në vështrim të studimit të vallzimit popullor, të kësaj krijimtarië kaq të pasun, të cilën na

29) J. de Rada, «Fiamuri i Arbërit», *Divinazione Etnografiche*, 15 Tetor, 1886.

30) Kopjet e tabllave ndodhen pranë Muzeut Etnografik — Arkeologjik, Tiranë.

e lanë trashëgim të parët tanë. Ky problem duhet të mos studjohet në mënyrë të shkëputun.

Në Europë dhe në Ballkan studjues të ndryshem prej kohësh, kanë mundë të hedhin dritë në këtë çashtje, pra, mbi origjinën e tyne. Për ne, siç u vu re edhe ma nalt, ky problem nuk ishte qëllim i punës sonë. Por, nuk do të ishte keq që të çfaqshim ndonji mendim lidhun me faktin se me cilët lloje kërcimesh të kësaj natyre përkojnë vallet tona.

Vallet e armëve ose ato me shpata praktikohen edhe sot e kësaj dite në shumë vende të Europës e gjetiu. Ato i përkasin një periudhe tepër të lashtë të shoqërisë njerëzore³².

Ndryshimet apo përgjasimet që paraqesin ato janë kushtëzue padyshim nga faktorë të ndryshëm, siç janë, kushtet jetësore, traditat, lëvizjet e mëdha të popujve, pushtimet, ambienti gjeografik, klima etj. Edhe nëqoftëse i përkasin një origjine të lashtë, kjo nuk do të thotë se këto valle kanë qenë dhe vazhdojnë të luhen njisoj prej të gjithve. Çdo popull krijon, njikohësisht përpunon, pasunon të njejtat gjini, ose motive që i përkasin një shtrimje të madhe gjeografike. Bile edhe këtu qëndron individualiteti, forca krijuese e një populli.

Një ndër vallet ma të njoftuna me karakter luftarak asht vallja Pirrike (Pyrrhic). Rreth origjinës së saj ka mendime të ndryshme: «Emni i kësaj valleje thonë se vjen nga Pirriku lindun në Gijdon të Kretës, ose nga Pirrua mbreti i Epirit.³³ Kjo valle arbërishte — shkruen De Rada — asht quejtun valle burrie dhe tue marrë emnin e Pirros asht quejtun valle Pirrike, d.m.th. e Pirros birit të Akilit³⁴. Gojdhana dhe shkrimtarë të vjetër e idealizojnë aq sa krijimin e valles e lidhin me Perëndeshën Rea, apo Athinaja. Me sa kuptohet, Pirrikja asht prototipi i valles luftarake aq sa ka marrë një kuptim simbolik³⁵. Megjithatë, problemi i origjinës së kësaj valleje mbetet për t'u zgjidhun. Vetë Sathas, ndonse ka mendim të kundërt, tue ba aluzion se çfarë kanë shprehë të tjerët, lidhun me vallen pirrike, shkruen këto: «Cili nga këta dy popuj, (asht fjala për shqiptarët dhe grekët — sh. N.A.) ka ma tepër të drejtë mbi këtë emën? Përkërisht të njejtën pyetje i vunë vehtes edhe të vjetrit, të cilët nuk ia dolën mb'anë për të përcaktue krijuesit e vërtetë të pirrikes».³⁶

Përgjithësisht në trevën e Ballkanit praktikohen valle armësh dhe, me sa duket, vallet tona përkojnë me to: në përmbajtjen dhe efektet

32) Sa i takon Ksenofonit, i cili na flet në shek. IV para e.r. për vallet e armëve të trakasve, ato kishin tashma të paktën një njimijvjeçar që i praktikojshin në Europë, dhe, kur ma vonë Taciti konstatoi në Gjermani përdorimin e disa valleve me shpata gjatë shekullit të parë mbas e.r., prap kishte shumë kohë që ato e kishin humbë kuptimin e tyne primitiv dhe që nuk pasqyrojshin ma tek gjermanët vetëm se lojna force dhe shkathtësie pa vlerë të madhe; për këtë arsye autorët e antikitetit nuk i zenë fare në gojë ato. Maurice A-L, Lonis, *Le Folklore et la Dance*, chap. XI d. *La dance des épées*, Conclusion, Paris 1963, p. 298-299.

33) Gafronco D'Aronco, *Storia della Danza Popolare e d'Arte*, Firenze, 1962, p. 88.

34) J. de Rada, *Idem*.

35) Simbas Platonit kjo valle (vallja Pirrike, sh. N.A.) ishte një imitim i luftës që pasqyronte fazat e ndryshme të saj dhe ekzekutohet e shoqueme me fyell (avillos), ose lyrë. Kërcimtarët ishin të armatosun dhe në fillim ekzekutojshin diçka të ngjashme me një parakalim, me kthesa anësore, me tërheqje mbrapa, me kërcime së nalti dhe me ulje. Vazhdojshin lëvizjet e sulmit dhe qëndresat mbrojtëse kur baheshin lëvizjet përkatëse nga luftëtari; si ato kur hudh shigjetën, ose shtizen, ose si ato kur ngul thikën në trupin e një kundërshtari (Të dhana nxjerrë nga enciklopedia greke); krahaso përshkrimin e masipërm me atë të Smilarit për vallen arnaute.

36) G.N. Sathas, *idem*, LXXX.

shprehëse, në funksionin e ndeshjes, në strukturën³⁷, në përdorimin e shpatës, si mjet goditës etj. Këtu, përta i përket përmbajtjes dhe karakterit të ndeshjes mund të përmendim, veç atyne që citojnë autorët e antikitetit, Moreskan që luhet në zonën e Adriatikut në Korcula e gjetiu. Diçka të përbashkët, veç karakterit të ndeshjes, ka në finalen e kësaj valleje me atë të Kërcimit me shpatë (Gjakovë). Tek Moreska në fund zezakët mundën dhe gjunjëzohen ndërsa të bardhët i kryqëzojnë shpatat mbi kryet e tyne... etj.³⁸. Edhe tek Kercimi me shpata, siç e thamë edhe ma nalt, i munduni gjunjëzohet, ndërsa mbrohet me shpatën e tij të kapun në të dy anët. Edhe vallet me shkop që luhen në Hungarinë V.L., sikur afrojnë për nga karakteri i ndeshjes me vallet tona. «Vallja e Shpatave (lexo Presa me tagana sh. N.A.) asht e vetmja valle luftarake origjinale me armë, që kemi në dispozicion të fiksueme në film e që paraqet ngjasim të madh me vallen në formë dueli me shkop që luhet në Hungari³⁹. Shpesh në vallet e armëve mjeti zavendësohet me thikë, pushkë, sopatë, ose edhe me shamia. Megjithatë asht e vështirë të mbrijmë në përfundime të sakta, lidhun me ndikimet dhe ngjajshmënitë tipologjike të këtij lloji kërcimi, për deri sa mungon një dokumentacion i mjaftueshëm si për tekstet koreografike ashtu edhe studimet e çdo vendi. Këto të dhana do të na jepshin mundësi ma të hollësishme, jo vetëm përta i përket karakterit të valleve, që luhen në trevën ballkanike, por edhe të aspekteve të tjera si: numrin e kërcimtarëve, llojin e mjetit që përdoret, shoqimin muzikor etj.

Në Evropën Qendrore dhe Perëndimore luhen tipe të tjera vallesh me shpata zinxhirë «Poignée de point» (dorezë dhe majë) ose, siç i thonë englezët «Hilt and point». Këto valle ndryshojnë me ato që luhen tek ne, bile do të thojshim edhe me ato që luhen në përgjithësi në trevën ballkanike⁴⁰. Këto tipe vallesh ndryshojnë: sepse shoqnohen me muzikë, luhen me shumë persona, në formacione të ndryshme dhe ma tepër nuk pasqyrojnë efektin e ndeshjes; shpata përdoret vetëm si mjet që lidh nëpërmjet dorezës dhe majës grupin e pa shkëputun të vallëtarëve në funksionin ritualistik. Studjues të ndryshëm kanë mundë të shofin në këto valle një nga çfaqjet ma të hershme të ritualit, atë të përsëritjes (imitiation) të jetës dhe të fortitetit bujqësor⁴¹. «Në mesjetë këto valle u banë privilegj i gildëve dhe përbajshin një pjesë kryesore të rituelit që i kush-tohej kalimit në shkallë të ndryshme të korporatës.⁴²

37) Tue folë për vallet e shpatave që luhen në Çekoslovakia, H. Laudova ndër të tjera shkruen: «Tipi i tretë — zakonisht solo ose valle armësh dyshe — bazohet në një shkallë të madhe në improvizim. Valle të tilla nuk kanë formë të kristalizue-me «Hannan Laudova, Sword dances and Their Paralleles in the C.S.S. Journal of the International Folk Music Council, vol. XV, 1963, p. 63. Nga kjo konstatojmë se, sikundër tek ne, dhe në vende të tjera, ekzistojnë valle me një formë koreografike të pa kristalizueme, si dhe e kërcyeme nga dy valltarë. Formën solo ose dyshe e hasim dhe në vallen «Hajdudh» dhe «Botolo». Shif. R. Wolfram. Vien, Altformen imtanz der volker des Pannonischen und Karpatenraumes, Volksmuzik Sudosteuropas 7. Band 1966, 109-139, Munchen.

38) Shif R. Wolfram, Der Volkstanz Als Kulturele Ausdrucksform Der Sudost-europaischen Volker, Munchen, 1962.

39) A. Bartalan. Idem.

40) Këto valle të tipit «Poignée de point» (sh. N.A.) «... s'kanë asgja të përbashkët me ato të antikitetit si Pyrriket, vallet e Couretëve, Skiphionëve dhe të tjera, as edhe me ato të Trakasve përshkrue prej Ksenophon-it, dhe ma vonë me ato të gjermanëve për të cilat flet Taciti, Maurice A.L. Louis. Idem.

41) Kurt Sachs mendon se tek primitivi shpata asht një simbol falik.

42) Maurice A.L. Louis. Idem.

Përkundrazi burimet e Antikitetit dhe studjues të ndryshëm vallet, që luhen në trevën ballkanike, i paraqesin si valle armësh e që kishin veç kënaqësisë një qëllim të caktuem në edukimin me frymë luftarake, në përgatitjen fizike, idealizmin dhe naltësimin e figurës së luftëtarit. Sigurisht, këtu asht fjala për një kohë të vonshme të shoqnisë njerëzore; për kohë ma të hershme nuk dijmë gja për sa i takon karakterit të këtyre valleve. Megjithëkëtë, mund të hetohet edhe në këto valle ndonji gjurmë e ritualit të vjetër si ajo e vdekjes dhe e ringjalljes ndonse në mënyrë të zbetë) me gjithë ndryshimet që mund të ketë pësue ajo me kohë. Këtu mund të përmendim vrasjen, mospremjën e kokës që në vallet e tipit «Poignée et point» quhet decapitation. Në Presën me tagana të Malsisë së Madhe, siç e përmendëm edhe ma nalt, në një nga variantet njeni nga luftëtarët vritet, i pritët kryet nga kundërshtari i tij, ndërkaq të tjerët e marin të vrasin dhe e nxjerrin jashtë. Për një veprim të tillë thuejse të ngjajshëm na flet Ksenofoni në përshkrimin e valles së Trakasve⁴³. Natyrisht, kjo gjurmë e vjetër e ritualit do të ketë humbë ndoshta funksionin fillestar të saj dhe, me kohë, ka marrë një kuptim të ri ashtu sikundër thotë Plehanovi. . . kur «luftëtari ideal bahet tek ata ideali i burrit⁴⁴. Në vallet me shpata që luhen tek ne, veçanërisht tek Presa me tagana dhe kërcimi me shpata, mund të hetohen dhe gjurmë të luftës të së mirës kundra së keqes shprehun në mënyrë simbolike.

RESUME

APERÇU SUR LES DANSES DE TYPE GUERRIER

L'exposé de l'auteur porte sur les danses de type guerrier, notamment sur: La taille à l'Epée, La Danse aux Epées, Le Premier Sabre. La Taille aux Epées est exécutée dans la partie N.-E. de l'Albanie, dans la Malessia Madhe, notamment à Kastrat, Hot et Grude (en deçà et en delà des frontières de l'Etat) et ailleurs. La Danse aux Epées est pratiquée dans les villages de la Malessie de Gjakove (en-delà des frontières actuelles d'Etat), comme à Rugove, Deçan, Lluke supérieure, etc. Le Premier Sabre est exécuté dans la région de Kukës. D'après l'attestation des soeurs Jan-ković et de L. Antoni, des variantes de cette danse ont été exécutées aussi dans la région de Prishtine, mais elles ont perdu désormais ce caractère viril au point qu'on a substitué même aux épées les foulards.

L'auteur expose ces danses assez en détail, examinant le matériel chorégraphique ainsi que les conditions historiques qui leur ont donné lieu. En même temps il parle de la façon d'exécution, du caractère et du

43) Si mbaruen së pimi dhe, mbasi mbaruen kangën e luftës (peon-in) trakasit u ngritën të parët dhe kërcyen të armatosun nën tingujt e fyellit; ata hudheshin nalt me lehtësi dhe i përplasnin thikat e tyne. Në fund njeni prej valltarëve e goditi kundërshtarin e tij, dhe të gjithë besuen që ai e plagosi atë, sepse ky i fundit u rrëxue për tokë me shumë art. Atëhere trakasi e çarmatosi të mundunin nga armët e tija dhe duel tue këndue një kangë për nder të Sitalces. Trakasit e tjerë e morën të vramin, i cili me të vërtetë nuk kishte pësue asnjë të keqe Xénophon, Anabase, L. VI chap. I, 5,6, p. 199-200. Paris.

44) G.V. Plehanovi, Idem, f. 123.

style, des particularités celles-ci qui sont faites ressortir au moyen de la description de ces danses.

D'après l'auteur la Taille à l'Épée et la Danse aux Épées représentent des variantes. La seule différence est que la première danse est exécutée sans musique, en silence, la deuxième au moyen du tupan (sorte de gros tambour). Les deux danses sont exécutées par deux danseurs et par un tiers qui intervient à interrompre la taille. Dans la Taille à l'Épée le rôle d'arbitre est fait par une femme; au contraire, dans La Danse aux Épées ce rôle est dévolu au tambourin. Quoique offrant de petites différences, ces deux danses appartiennent à un type. Envisagées sous l'angle de la structure chorégraphiques et de l'exécution des mouvements, elles n'offrent pas une cristallisation, situées qu'elle sont entre le jeu, d'une part, et la danse, de l'autre. La fonction principale est le combat singulier, un engagement à mort entre deux hommes. C'est pourquoi l'épée exprime l'effet de ce combat.

Les données recueillies par l'auteur ont permis de constater que la femme, par sa présence, ne penche en faveur d'aucun des guerriers. Elle se tapit dans une attitude impartiale. Son but final est, au même titre que celui du tambourin, à empêcher l'effusion de sang. Il est probable que l'intervention de la femme ne soit pas un élément trop ancien.

Au contraire, pour ce qui est de la forme et du mode d'exprimer la pensée, le Premier Sabre (en albanais Këllico) offre un type de danse à part. Cette danse est jouée habituellement par les vieillards du village de Shtiqen: quatre danseurs, qui tiennent dans leur main droite chacun un sabre. Un esprit épique empreint ses mouvements, quoiqu'elle soit exécutée à un rythme lent. Tout mouvement, tout geste émane de l'intérieur, du fait que chacun des danseurs vit cette danse dans ses évolutions. Un trait propre à cette danse est le mouvement asymétrique, qui extériorise des éléments développés au point de vue de la plastique et des nuances². L'épée n'a qu'une fonction démonstrative. Un rôle dans l'exécution de la danse a le chalumeau, notamment la grand' caisse, qui par ses coups puissants influe non seulement sur l'état d'âme des danseurs, mais également sur l'accentuation des mouvements à des moments donnés.

Pour ce qui est de la Taille aux Épées, exécutée en silence, sans musique, l'auteur polémise avec A. Bartalan, qui explique ce phénomène par une civilisation plus ou moins appauvrie des tribus qui ont vécu en Albanie septentrionale. L'auteur est de l'avis contraire. Pour ce qui est de cette particularité d'accompagnement sans musique de la danse chez nous, il s'agit d'une tradition passée en patrimoine, dont la source doit être cherchée dans le contenu même, dans le mode d'expression au moyen des éléments plastiques qui ont conditionné directement sa structure, le rythme de la danse, qui a pris naissance et s'est développée dans des conditions données.

L'auteur passe en revue aussi les opinions exprimées par des auteurs étrangers tels Atheneus, Tallozy, Smilari, Hughes, de Rada Barkata, Sathas, Madame Chénier, Bartalan, et d'autres, qui ont brossé des descriptions sur les danses de caractère guerrier et viril exécutées dans les territoires habités naguère par les Albanais.

L'auteur fait une tentative, quoique dans des lignes générales, à dresser une parallélisme entre les danses exécutées dans le territoire albanais avec celles de la région balkanique, considérées comme des danses d'armes. On y constate parfois des éléments communs, notamment

pour ce qui est du contenu et de caractère de ces danses, en même temps que d'autres éléments décrits par Tacite pour les danses des Thraces, ou par Platon dans la Danse pyrrhique. La Danse Pyrrhique, d'après l'auteur, doit constituer un objet de recherches et d'études plus profondes concernant l'origine, puisque, comme on sait, les avis sont partagés à son sujet.

Des éléments voisins peuvent être constatés aussi entre nos danses et celles Botolo, exécutées en Hongrie, notamment pour ce qui est du caractère du combat, ou bien dans quelque autre danse.

Au contraire, les danses dont il est question dans cet article, diffèrent des danses d'épées exécutées dans l'Europe occidentale et centrale. Celles-ci se font distinguer pour leur caractère rituel, comme par exemple par le type connu Poignée et point, ou bien comme s'expriment les Anglais Hilt and point.

Dans l'exposé ci-contre en albanais, l'auteur a voulu offrir un matériel utile sur les danses de ce genre, matériel recueilli durant les expéditions organisées par l'Institut du folklore, et aboutir à des conclusions. Néanmoins, l'exposé en question, ne prétend pas d'avoir résolu définitivement ce problème.